

TRASHËGIMIA FETARE, IDENTITETI RAJONAL DHE PËRDORIMI SI RESURS PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT NË QARKUN E KORÇËS

¹Edlira MENKSHI;

²Nevila CINAJ;

³Fjoralba PRIFTI;

⁴Ermiona BRAHOLLI

^{1 4} Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë,
Fakulteti Edukimit dhe Filologjisë,
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë,
emenkshi@unkorce.edu.al
ebraholli@unkorce.edu.al

² Departamenti i Turizmit, Fakulteti i Biznesit,
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës,
nevilacinaj@uamd.edu.al

³ Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë,
prifti.fjoralba@gmail.com

Abstrakt

Trashëgimia fetare përfshin një sërë objektesh dhe vendesh të shenjta që pasqyrojnë diversitetin historik, kulturor dhe tradicional në mbarë botën. Krahas ndërtesave fetare, si kisha, xhami, sinagoga, manastire, vende të shenjta dhe artefakte të ndryshme, tipologjia e trashëgimisë fetare përfshin edhe praktika shpirtërore si pelegrinazhet dhe festimet fetare.

Komunitetet lokale në Shqipëri e vlerësojnë trashëgiminë fetare si një pjesë thelbësore të identitetit të tyre kulturor, të ndjenjës së përkatësisë dhe të historisë së përbashkët. Ajo konsiderohet njëkohësisht edhe një burim me potencial të rëndësishëm turistik.

Në qarkun e Korçës, rrethanat historike kanë bërë të mundur zhvillimin dhe bashkëjetesën e tre komuniteteve kryesore fetare: të krishterëve, myslimanëve dhe bektashinjve. Gjurmët kulturore të këtyre komuniteteve reflektohen qartë në shumëllojshmërinë e objekteve të kultit që gjenden në zonë. Për shkak të vlerave të tyre si trashëgimi kulturore kombëtare, 32 prej këtyre objekteve janë shpallur “Monument Kulture” i kategorisë së parë. Punimi ka si qëllim evidentimin e rëndësisë së trashëgimisë fetare në qarkun e Korçës, duke analizuar vlerat ndërtimore, artistike dhe shpirtërore që ajo

mbart. Gjithashtu, përmes analizës së perceptimit të komunitetit lokal vlerësohen mundësitë që ekzistojnë për zhvillimin e turizmit, si rezultat i rritjes së interesit të vizitorëve ndaj objekteve të kultit në këtë qark, si edhe sfidat që lidhen me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

Nëpërmjet përdorimit të teknologjisë GIS janë përcaktuar disa nga itineraret turistike që mund të ofrohen në funksion të zhvillimit dhe promovimit të trashëgimisë fetare.

Fjalë kyçe: *Objekte kulti, vlera artistike, komunitet lokal, turizëm fetar, menaxhim.*

RELIGIOUS HERITAGE, REGIONAL IDENTITY, AND USE AS A RESOURCE FOR TOURISM DEVELOPMENT IN THE KORÇA COUNTY

Abstract

Religious heritage comprises a series of objects and sites that represent the diversity of history, traditions, and cultures worldwide. In addition to religious buildings — such as churches, mosques, synagogues, monasteries, holy places, and artifacts — the typology of religious heritage also includes pilgrimages and religious celebrations. Local communities in Albania support religious heritage as an important part of their cultural heritage, identity, and belonging, but also as a source of tourism potential. In Korça region, historical circumstances have enabled the cultivation and coexistence of three main religious communities —Christians, Muslims, and Bektashi —whose cultural traces are reflected in the existence of various cult objects. Given their status as national cultural heritage, 32 of them have been declared “Cultural Monuments” of the first category.

This study aims to identify the importance of religious heritage in the communities of Korça region, analyzing at the same time the current situation and their construction, artistic, and spiritual values. The study also evaluates the opportunities for developing tourism by increasing visitors' interest in the region's religious sites, as well as the challenges of maintenance and management.

Using GIS technology, several tourist itineraries have been identified to support the development of religious heritage.

Keywords: *Religious sites, artistic values, local community, religious tourism, management.*

1. Hyrje

Trashëgimia është një pasuri me vlera multidimensionale, së cilës i atribuohen përmasa historike, kulturore, shkencore dhe ekonomike (Ma, 2023). Brenda këtij spektri të gjerë, një vend të rëndësishëm zë trashëgimia fetare ose religjioze. Termi “trashëgimi fetare” përdoret nga ICOMOS për të përkufizuar “çdo formë pasurie që ka lidhje shpirtërore ose fetare: kisha, manastire, faltore, shenjtërore, xhami, sinagoga, tempuj, peizazhe të shenjta, korije të shenjta dhe elemente të tjera të peizazhit” (ICOMOS, 2005). Origjina e vetë konceptit të trashëgimisë kulturore lidhet ngushtësisht me shfaqjen e praktikave fetare. Historiani Duby (1994) thekson se format më të hershme të adhurimit lindën në shoqëritë prehistorike, ku besimet fetare çuan në krijimin e vendeve të shenjta, tempujve dhe ritualeve — elemente që vijojnë të jenë pjesë integrale e trashëgimisë kulturore edhe sot (Kombieni, 2025). Trashëgimia fetare përfaqëson një sërë vlerash të natyrshme dhe të brendshme që e bëjnë atë të rëndësishme si për individët, ashtu edhe për institucionet. Ajo përfshin dimensione të prekshme dhe të paprekshme dhe njihet për vlerat e saj kulturore, fetare, historike, artistike, arkitektonike, sociale, folkloristike, politike dhe antropologjike (Franceschini, 2024).

Tipologjitë e trashëgimisë fetare janë po aq të shumëllojshme sa edhe vetë praktikat shpirtërore, duke përfshirë trashëgiminë e ndërtuar, objektet dhe elementet e paprekshme, si edhe rrugët e pelegrinazhit dhe festimet fetare. Objektet fetare përbëjnë shpesh kryevepra të vërteta arkitekturore. Ato pasqyrojnë mjeshtërinë, artin dhe përkushtimin e komuniteteve që i kanë ndërtuar dhe ofrojnë dëshmi të çmuara mbi teknologjitë dhe materialet e kohës. Nga harqet e larta të katedraleve gotike te gdhendjet e hollësishme të tempujve hindu, këto struktura mbeten dëshmi të prekshme të kreativitetit dhe shpirtit njerëzor.

Në Europë gjenden mbi 500 000 kisha, sinagoga, tempuj dhe xhami, të cilat janë pjesë e pandashme e historisë së kontinentit. Këto objekte dallohen për arkitekturën e tyre monumentale dhe vlerat artistike të shquara, duke kontribuar në krijimin e një ndjeshmërie të përbashkët ndaj trashëgimisë kulturore, pavarësisht besimit fetar. (Tamma & Sartori, 2017)

Në kontekstin rajonal, trashëgimia fetare e një lokaliteti përbën një aspekt themelor të identitetit të tij kolektiv, duke lidhur brezat e kaluar, të tanishëm dhe të ardhshëm përmes praktikave simbolike, objekteve të kultit dhe hapësirave që mbartin vlera shpirtërore e historike (Kombieni, 2025). Ajo luan një rol thelbësor në formësimin e identitetit të njerëzve, jo vetëm sepse forcon sistemin e besimeve, por edhe sepse siguron një ndjenjë të qëndrueshme përkatësie sociale dhe fetare (Alvarez, Gonzalez, & Fernandez, 2022).

Objektet e kultit na ofrojnë të dhëna të çmuara mbi historinë, kulturën dhe besimet e komuniteteve që i kanë krijuar. Qoftë kisha të vjetra manastire, xhami, sinagoga apo vende të qeta natyrore të shenjta, këto hapësira mbartin një ndjenjë të veçantë simbolike dhe shpirtërore. Ato kanë qëndruar në kohë për shekuj, shpesh për qindra vjet, dhe dëshmojnë mënyrën se si kultura të ndryshme janë ndërthurur dhe kanë bashkëjetuar përgjatë historisë.

Përveç rolit të tyre në ruajtjen e identitetit kolektiv, trashëgimia fetare është shndërruar edhe në një aset të rëndësishëm për zhvillimin social dhe ekonomik të komuniteteve. Në kuadër të praktikave të udhëtimit, njerëzit lëvizin jo vetëm për motive turistike, por edhe për arsye fetare apo shpirtërore, duke vizituar vende të shenjta dhe objekte të kultit. Udhëtimet me karakter fetar, si pelegrinazhet, përbëjnë një ndër format më të hershme të turizmit dhe vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm edhe sot (Rinschede, 1992).

Siç theksojnë autorët, ***“turizmi fetar përfaqëson një formë turizmi të pozicionuar mes pelegrinazhit dhe turizmit klasik, ku synimi është arritja e një ekuilibri midis dimensionit fetar dhe atij turistik”*** (Choe, 2024).

Në të vërtetë, ekzistojnë lidhje të dukshme ndërmjet turizmit dhe pelegrinazhit, si në aspektin e vetë udhëtimit, ashtu edhe në përvojën kolektive që krijohet brenda komunitetit (Iliev, 2020).

Gjatë dekadave të fundit, destinacionet tradicionale të pelegrinazhit janë shndërruar gjithnjë e më shumë në hapësira turistike me funksione të shumëfishta. Këto vende mirëpresin jo vetëm besimtarët që udhëtojnë për motive shpirtërore, por edhe vizitorë të tërhequr nga trashëgimia historike, vlerat arkitekturore, kulturore apo artistike që

ato ofrojnë (Sanchez, Garcia , Rama , & Oliveira, 2018). Vizitat në sitet e trashëgimisë kulturore janë bërë gjithnjë e më të përhapura ndër vizitorët me prejardhje të ndryshme kulturore dhe fetare, duke përfshirë edhe ata që nuk praktikojnë asnjë fe (Kandil, 2024).

Pra sipas Ron *“Turizmi religjioz mund dhe përfshijë edhe forma të tjera të aktiviteteve që nuk janë në kategorinë e pelegrinazhit”* (Ron , 2009).

Në objektet e kultit kristian, aktivitetet turistike dhe fetare marrin forma të ndryshme. Këto përfshijnë vizitat në site të njohura për artin dhe arkitekturën e tyre, si p.sh. Vatikani në Itali, si edhe vizitat në vende me rëndësi të veçantë në traditën kristiane, si fshati Nazaret në Izrael. Përveç tyre, zhvillohen edhe pjesëmarrje në konferenca dhe konventa fetare, të cilat shpesh kombinohen me aktivitete turistike dhe kulturore.

Aktivitete të tjera janë edhe vizitat në komunitete lokale, të cilat synojnë të tregojnë solidaritetet dhe të ofrojnë mbështetje për njerëzit që ndihen të përndjekur ose të marginalizuar për shkak të besimit të tyre, veçanërisht në kontekstin e minoriteteve fetare (Tamma & Sartori, 2017). Vendet e shenjta janë bërë komode dhe përshtatur edhe për kërkesat e turistëve.

Shqipëria zotëron një trashëgimi të pasur kulturore, në të cilën trashëgimia fetare zë një vend të veçantë dhe përbën një komponent të rëndësishëm të identitetit kombëtar. Pelegrinazhet dhe udhëtimet në vendet e shenjta mbeten praktika të gjalla, të cilat zhvillohen kryesisht nga vizitorët vendas. Ndër më të rëndësishmit përmenden pelegrinazhi në Kishën e Shën Ndoit në Laç dhe pelegrinazhi në malin e Tomorrit.

Përveç pushtimeve historike, të cilat shpesh tentuan të shkatërronin ose të transformonin kontekstin kulturor të vendit, një ndër periudhat më kritike që ndikoi ndjeshëm në dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, veçanërisht asaj fetare, ishte periudha e komunizmit. Gjatë kësaj periudhe, një pjesë e rëndësishme e objekteve fetare, përfshirë edhe ato të shpallura monument kulture me vlera të larta, u shkatërruan, u dëmtuan rëndë ose u transformuan në funksione të tjera.

Shqipëria përbën një rast unik në historinë botërore, pasi është i vetmi vend që ndaloi me ligj ushtrimin e besimit fetar për më shumë se një

çerek shekulli, nga viti 1967, me nisjen e të ashtuquajturit “Revolucion Kulturor”, deri në vitin 1990. Kjo ndërprerje e detyruar e praktikave fetare pati pasoja të thella në jetën shpirtërore të qytetarëve dhe në ruajtjen e trashëgimisë religjioze (Shehu & Zaloshnja, 2024).

Monumentet e arkitekturës osmane pësuan dëmet më të rënda. Rreth 1127 xhami në mbarë vendin u transformuan për përdorime të tjera, ndërsa shumë të tjera u shkatërruan plotësisht ose u zëvendësuan me ndërtesa të reja, si shkolla, parqe apo blloqe apartamentesh (Basha & Zagdic, 2025).

Me rënien e komunizmit u krijuan mundësitë që të ruheshin dhe restauroheshin monumentet e trashëguar.

Në të gjithë territorin e vendit, ndodhen të pranishme monumente kulturi me vlera të rëndësishme arkitekturore dhe artistike. Komunitetet lokale janë të ndërgjegjshme për vlerat e tyre dhe duan t’i përdorin në funksion të zhvillimit social-ekonomik, nëpërmjet turizmit.

1. Metodologjia e studimit

Studimi është ndërmarrë me qëllim evidentimin e trashëgimisë religjioze/fetare, vlerësimin e rolit të saj në formësimin e identitetit rajonal dhe analizimin e potencialit që ajo ofron për zhvillimin e turizmit. Për realizimin e tij janë përdorur të dhëna sasiore dhe cilësore, primare dhe sekondare, të mbledhura nëpërmjet hulumtimit bibliografik dhe anketimit në terren.

Nëpërmjet shqyrtimit të literatures, libra, botime shkencore dhe artikuj akademikë, u përcaktuan konceptet themelore dhe rëndësia e trashëgimisë fetare. Vlerat e objekteve të kultit në qarkun e Korçës u evidentuan duke u mbështetur në një sërë publikimesh të autorëve vendas dhe studimeve të dokumentuara për këtë zonë.

Për të arritur objektivat kërkimore u hartua një pyetësor i strukturuar, i cili iu shpërnda komunitetit lokal të qarkut, kryesisht në zonat ku ndodhen objekte fetare. Target-grupi i anketuar synoi të përfshinte individë me profil të larmishëm sa i përket moshës, gjinisë dhe nivelit arsimor. Pyetësori u realizua në platformën Google Forms dhe u shpërnda përmes një lidhjeje elektronike gjatë muajve nëntor–dhjetor

2025. Nga mbi 100 individë të kontaktuar, 92 prej tyre iu përgjigjën plotësisht anketës.

Anketa u struktura në tre seksione kryesore. Në seksionin e parë (A) u mbledhën të dhënat demografike dhe sociale të të anketuarve. Seksioni i dytë (B) synoi të vlerësonte nivelin e njohjes së trashëgimisë fetare në zonën e tyre dhe në të gjithë qarkun e Korçës. Ndërsa në seksionin e tretë (C), pyetjet u fokusuan në perceptimin dhe vlerësimin e mundësive të përdorimit turistik të trashëgimisë fetare në qark.

Pyetjet ishin të kombinuara, të hapura dhe të mbyllura. Ndër pyetjet e mbyllura, pjesa më e madhe e atyre në seksionin B dhe C u vlerësuan përmes shkallës Likert me pesë nivele: *nuk jam tërësisht dakord; nuk jam dakord; pjesërisht dakord; dakord; plotësisht dakord*. Të dhënat e mbledhura u përpunuan përmes Google Forms dhe u analizuan duke u kombinuar me informacionin cilësor, me synim arritjen e qëllimit të studimit.

2. Trashëgimia fetare dhe zhvillimi i turizmit

Rrethanat historike kanë bërë të mundur që në qarkun e Korçës të kultivohen dhe të bashkëjetojnë tre komunitete apo besime fetare kryesore: ai i krishterë, mysliman dhe bektashi (Menkshi, 2020).

Këto besime kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identitetin kulturor të trevave të qarkut, gjurmët e të cilave janë pasqyruar në ekzistencën e një morie objektsh kulturi. Nisur nga vlerat arkitekturore, artistike dhe shpirtërore, që ato përmbajnë një pjesë e tyre janë shpallur monumente kulture të kategorisë së parë (36 kisha, një xhami, një teqe dhe një tyrbe) (Figura 1).



Figura 1. Harta e vendodhjes së objekteve të kultit në qarkun e Korçës

Përveç vlerave të tyre fetare, këto monumente janë shndërruar vitet e fundit në një nga pikat kryesore të interesit për vizitorët vendas dhe të huaj. Vizitat në objektet e kultit shpesh përfshihen si pjesë e eksperiencës turistike në destinacionet përkatëse.

Kishat e Voskopojës, kishat e Vithkuqit, Bazilika e Linit, kisha e Ristozit, kisha e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit, si edhe kishat eremite në Prespë, janë sot ndër objektet më të vizitueshme si nga turistët vendas ashtu edhe nga ata të huaj.

Në qytetin e Korçës, një ndër objektet e kultit me vlera të veçanta është xhamia e Iliaz Bej Mirahorit. Ajo përfaqëson një atraksion të

rëndësishëm turistik, jo vetëm për vlerat e saj arkitekturore dhe fetare, por edhe për rëndësinë historike që mbart, pasi konsiderohet si objekti që shënoi fillimet urbanistike të qytetit të sotëm. Xhamia është ndër më të vjetrat e këtij tipi në Shqipëri (xhami me sallë të mbuluar me kupolë).

Sipas një mbishkrimi të vonë (1872–1873) vendosur mbi portën e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1495–1496 (901 H) nga Iliaz Beu, me origjinë nga Panariti, i njohur si Mirahor, komandant i kalorësisë së Sulltan Bajazitit II (Frashëri & Dashi, 1978), (Meksi, 2007).

Krahas xhamisë edhe *Katedralja Ringjallja e Krishtit* në qytetin e Korçës e ndërtuar në vitin 1994, shërben për kryerjen e të gjitha riteve fetare të besimtarëve të krishterë ortodoksë. Katedralja është simbol i kishës së Shën Gjergjit e ndërtuar në vitin 1881 (përfunduar në 1905) në vendin ku sot është vendosur bashkia (Llukani, 2019) . Për fat të keq kisha u shkatërrua nga regjimi komunist në vitin 1967. Ndonëse e re dhe nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës, katedralja Ringjallja e Krishtit, përbën një nga simbolet kulturore të qytetit, me vlera artistike në arkitekturën e jashtme dhe zbukurimet e brendshme murale të saj. Në vazhdim të traditës së pikturimit të kishave, është për t'u evidentuar fakti se besimtarët ortodoksë janë duke kontribuar në veshjen e brendshme me piktura murale. *E ndodhur në qendër të qytetit katedralja është objekti kulturor që vizitohet dhe vlerësohet nga të gjithë turistët e huaj dhe vizitorët që vijnë në qytetin e Korçës.* Përveç vlerave arkitekturore dhe fetare kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Boboshticës, Prespës dhe gjithë kishat e tjera në qarkun e Korçës, dallohen edhe për vlerat artistike të pikturave murale, afreskeve, ikonostaseve dhe ikonave.

Një atraksion shpirtëror me vlera turistike përbëjnë edhe ritualet dhe organizimi i festave fetare në objektet e kultit të përmendura më sipër. Ritualet fetare përfaqësojnë praktika komunitare që shpesh ndërthurin veprime simbolike, lutje dhe ceremoni të kryera nga individë ose grupe që i përkasin besimeve përkatëse. Nëpërmjet këtyre ritualeve, besimtarët marrin pjesë aktive në trashëgiminë kulturore të komunitetit të tyre fetar, duke kultivuar dhe transmetuar vlerat dhe traditat ndërmjet gjeneratave.

Ritualet luajnë një rol thelbësor në formimin e identitetit kulturor, pasi ato kontribuojnë në krijimin e ndjenjës së kohezionit shoqëror,

ndarjen e vlerave dhe forcimin e memories kolektive brenda komuniteteve fetare. Ato funksionojnë si shënjes të identitetit kulturor, duke dalluar një bashkësi fetare nga një tjetër, ndërkohë që përforcojnë ndjenjën e përkatësisë dhe solidaritetit brenda grupit.

Për shembull, ritualet e pagëzimit, kungimit dhe kurorëzimit në besimin e krishterë nuk përfaqësojnë vetëm momente të rëndësishme shpirtërore, por gjithashtu krijojnë një identitet të përbashkët midis besimtarëve të krishterë. E njëjta gjë vlen edhe për ritualet e komuniteteve myslimane dhe bektashiane që bashkëjetojnë në të njëjtin territor. Duke jetuar pranë njëri-tjetrit, këto komunitete ndjekin ritualet e besimeve të tyre përkatëse, ndërsa njëkohësisht ruajnë respektin dhe tolerancën ndaj praktikave fetare të njëri-tjetrit.

Për më tepër, ritualet fetare shpesh integrojnë elemente të trashëgimisë kulturore jomateriale, duke përfshirë muzikën, kërcimin, veshjen tradicionale dhe praktikat kulinare, të cilat pasurojnë përvojën ceremoniale dhe kontribuojnë në ruajtjen e identitetit kulturor të komuniteteve (Santiago, 2023).

Praktikimi i ritualeve në ditë të shënuara fetare tërheq jo vetëm banorët vendas dhe të qarkut, por edhe vizitorë nga zona të tjera të Shqipërisë dhe, në shumë raste, edhe vizitorë të huaj që vizitojnë destinacionin. Festimet fetare në qarkun e Korçës përbëjnë një element të rëndësishëm të turizmit kulturor, pasi u ofrojnë vizitorëve mundësinë të njihen me traditat, zakonet dhe përvojat shpirtërore të komuniteteve lokale.

Ndër festimet më të rëndësishme përmenden: **Festa e Ristozit, Festa dhe panairi i Shën Prodhomit, Pashkët Ortodokse, Sulltan Nevruzi, Festa e Bajramit, Festa e Hocishtit, Festa e Shën Mërisë në Boboshticë, Festa e Shën Mërisë në Dardhë, Festa e Shën Pjetrit në Vithkuq, Festa e Hashures**, si edhe festimet pranë **Teqesë së Qesarakës**. Ngjarje të tilla si procesionet e Pashkëve, tregjet e Krishtlindjes, festat e komuniteteve dhe pelegrinazhet e organizuara në ditë të shënuara, krijojnë mundësi të shkëlqyera për përfshirje kulturore dhe përjetim të atmosferës së komunitetit lokal. Angazhimi i komunitetit në këto aktivitete është thelbësor. Duke qenë se ata jetojnë pranë këtyre siteve, kontributi i tyre ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ruajtjen, sigurinë dhe mirëmbajtjen e objekteve të

kultit. Për më tepër, përfshirja aktive i bën ata më të vetëdijshëm për vlerat e trashëgimisë dhe nxit përgjegjshmërinë për mbrojtjen e tyre. Për më tepër, kur janë të përfshirë, ata kanë më shumë interes të kujdesen për sigurinë dhe mirëmbajtjen e objekteve. Ka disa mënyra të angazhimit të komunitetit si janë: angazhimi vullnetar në mirëmbajtjen e objekteve, pjesëmarrja në eventet lokale dhe ndarja e historive dhe traditave që lidhen me objektet fetare. Qeverisjet lokale në qark përpiqen të promovojnë objektet kulturore dhe festimet fetare në mënyrë që të stimulojnë zhvillimin e ekonomive lokale.

2.1.Mendimi i komunitetit për trashëgiminë fetare të qarkut dhe përdorimin e saj


Nuk ka statistika të sakta lidhur me numrin e vizitorëve në objektet e kultit por në terren është vërejtur një rritje e interesit të tyre. Në anketimin e zhvilluar me banorë lokalë, morën pjesë 92 individë nga qarku i Korçës, 31.5 % nga qyteti i Korçës, 29.3 % nga qyteti i Pogradecit, pjesa tjetër nga Maliqi, Erseka, Devoll, Boboshticë, Voskopojë, Dardhë, Vithkuq, Pustec etj. Pjesa më e madhe 62 % (57) ishin femra dhe 38% (35) ishin meshkuj. Përsa i përket moshës pjesa më e madhe e të anketuarve i përkasin grupmoshës 18-28 vjet (32 individë) ndjekur nga grup moshat 40-50 vjet dhe 51-60 vjet me nga 22.8 % ose 21 individë secila dhe 51-60 vjet 15.2 % (14 individë). Moshë mbi 61 vjet zë 4.3 % (4 individë). Lidhur me arsimin pjesa më e madhe e të anketuarve janë të mirarsimuar ku 58.7 % kanë ndjekur arsimin e lartë, 18.5% kanë mbaruar edhe studimet Master, 17.4 % arsimin e Mesëm dhe 5 % atë 9-vjeçar.

Në lidhje me seksionin e dytë *“Sa e njohin banorët trashëgiminë fetare të zonës dhe qarkut?”*, për pyetjen *“A e dini se objektet e kultit janë pjesë e trashëgimisë kulturore kombëtare?”* pjesa më e madhe 60.9% (56) janë përgjigjur se e dinë një gjë të tillë, 19.6% (18 individë) janë përgjigjur ndoshta dhe 19.6 (18) të tjerë nuk e dinë. Pyetjes *“A i njihni objektet e kultit në zonën tuaj?”*, 70.7% (65) i janë përgjigjur *“njoh disa”*, ndërkohë që 20.7% (19) i njohin të gjitha dhe 8.7.% (8) kanë pohuar se nuk i njohin. Nga përgjigjet e banorëve për të përmendur tre objektet e kultit më të vizituara sipas perceptimit të tyre janë evidentuar: Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit, Katedralja

Ringjallja e Krishtit, Kishat e Voskopojës dhe Teqeja e Melçanit në të njëjtën zgjedhje.

Në lidhje me pyetjen “A i frekuentoni objektet e kultit në zonën tuaj?” 65% (60) janë përgjigjur se i vizitojnë me raste, në ditë të shënuara, 23.9% (22) gjithmonë në përditshmëri dhe 10.9% (10) janë shprehur se nuk i vizitojnë.

Nga të anketuarit e pyetur “A i ndiqni ritualet që lidhen me besimin tuaj fetar?”, 58.7% (54), janë shprehur se i ndjekin me raste në ditë të shënuara, 38% (31) gjithmonë në përditshmëri dhe vetë 7.6% kanë pohuar se nuk i ndjekim. Në vazhdim pyetjes “A organizohen festime fetare në zonën tuaj?”, pjesa më e madhe 64.1% (59) pohojnë se organizohen në ditë festash fetare kombëtare, 31,5 % (29) se organizohen në ditë të veçanta shenjtorësh (për të tre besimet) dhe 4.3% (4) nuk organizohen. Për sa i përket pyetjes “A organizohen pelegrinazhe në zonën tuaj 45.7%, (42) kanë pohuar se organizohen në ditë festash kombëtare, 29.3% (27) nuk organizohen dhe 25% (23) në ditë të veçanta shenjtorësh. Të pyetur nëse në dijeninë e tyre marrin pjesë në festime banorë, vizitorë vendas dhe vizitorë të huaj, të anketuarit janë përgjigjur 53% (49) banorë nga gjithë qarku, 51,1%, (47) vetëm banorë vendas dhe të zonës, 45% (42) marrin pjesë edhe vizitorë nga Shqipëria dhe 42% (39) me raste edhe vizitorë të huaj (grafik.1).



Grafik.1. Pjesëmarrja e banorëve, vizitorëve vendas dhe të huaj në festimet fetare

Ky rezultat tregon se festimet fetare në zona të veçanta të qarkut janë më së shumti me rëndësi për komunitetin lokal dhe banorët e qarkut sesa në nivel kombëtar. Përjashtim bëjnë festimi i Pashkës Ortodokse dhe Krishtlindjes ku për të festuar me banorët e qytetit të Korçës vijnë edhe banorë nga gjithë Shqipëria e më gjerë.


Në lidhje me perceptimin e banorëve vendas për turistët fetarë, pyetjes “A vizitohen objektet e kultit në zonën tuaj?”, pjesa më e madhe 62% (57) i janë përgjigjur ndonjëherë nga vizitorë vendas dhe të huaj, 31.5 % (29) gjithmonë nga vizitorë vendas dhe të huaj dhe 6.5% (6) asnjëherë nga vizitorë vendas dhe të huaj.

Për pyetjen “Shprehni mendimin tuaj për pohimet e mëposhtme” sipas shkallës së Likert, për pohimin “Hapja e objekteve të kultit për vizitorët ka ndikuar në rritjen e turizmit”, pjesa më e madhe e të pyeturve 49 % (45 individë) janë përgjigjur “jam dakord dhe shumë dakord”, ndërkohë 40 % (36 individë) “jam pjesërisht dakord”, dhe 16 % (11 individë) nuk kanë qenë dakord. Kjo tregon se në perceptimin e banorëve, nga edhe çfarë ata kanë konstatuar në zonën e tyre, vizitorët kanë një qasje pozitive ndaj objekteve të kultit, çka ka ndikuar edhe në rritjen e pranisë së tyre aty ku këto objekte janë të pranishme (grafik.2)

Për pohimin “Turistët me interes objektet e kultit janë të mirëpritur”, 76% (73) janë shprehur dakord dhe shumë dakord , ndërkohë që 16% (14) janë shprehur pjesërisht dakord dhe vetëm 8% (5) janë shprehur nuk janë dakord. Kjo përqindje e lartë tregon një dashamirësi dhe mikpritje ndaj vizitorëve vendas dhe të huaj me interes vizitën në objektet e kultit. Në të njëjtën kohë komuniteti është nxitës i zhvillimit të turizmi fetar.

Për pohimin “Turistët fetarë janë të ndryshëm nga turistët e zakonshëm”, perceptimi i banorëve 42% (40) pjesërisht dakord, 35% (33) janë shprehur dakord dhe shumë dakord dhe vetëm 23% (19) nuk kanë qenë dakord me pohimin.

2. Shprehni mendimin tuaj për pohimet e mëposhtme:A. 1=nuk jam tërësisht dakort 2= nuk jam dakort 3= pjesërisht dakort 4= dakort 5 = plotësisht dakort




Grafik 2. Opinioni i komunitetit në lidhje me interesin e vizitorëve për trashëgiminë fetare

Lidhur me pohimin “Numri i turistëve që vizitojnë objektet e kultit është rritur”, 44% (42) janë shprehur që janë dakord dhe shumë dakord, 41% (38) janë shprehur që janë pjesërisht dakord, dhe 15% (12) nuk kanë qenë dakord. Në perceptimin e banorëve për pohimin “Turistët kanë shumë interes për të vizituar objektet fetare”, pjesa më e madhe 50% (46) i janë përgjigjur pjesërisht dakord, 43% (41) jam dakord dhe shumë dakord dhe 7 % (5) nuk janë dakord.

Pohimit “Turistët kanë interes për të ndjekur ritualet dhe festimet”, pjesa më e madhe 50% (46) janë përgjigjur pjesërisht dakord, 38% (36) jam dakord dhe shumë dakord dhe vetëm 12% (11) kanë pohuar që nuk janë dakord.

Në lidhje me pohimin “Turistët kanë interes të mësojnë për historinë dhe besimet fetare në zonë”, 59% (54) janë shprehur dakord dhe shumë dakord me pohimin, 30% (28) pjesërisht dakord dhe 11% (10) nuk kanë qenë dakord. Rezultatet tregojnë se në perceptimin e banorëve turistët kanë më shumë interes për të njohur historinë dhe besimet fetare në zonat që vizitojnë sesa për të ndjekur ritualet ose festimet fetare.

Të pyetur a mendoni se trashëgimia fetare është e rëndësishme për komunitetin tuaj lokal, pjesa më e madhe 64.1% (59) janë përgjigjur se është një aset për komunitetin, 36.9% mund të konsiderohet si e tillë (grafik 3).



Grafik.3. Opinioni në lidhje rëndësinë e trashëgimisë për komunitetin lokal.

Në përfundim të pyetjes së hapur “Në mendimin tuaj, si do të mund të rritej vëmendja e vizitorëve ndaj trashëgimisë fetare në zonë?”, banorët janë shprehur se vëmendja dhe interesi i vizitorëve mund të rriten përmes këtyre veprimeve kryesore:

- **Promovim më i mirë dhe më i gjerë i objekteve të kultit**, nëpërmjet materialeve informuese, platformave online dhe fushatave të dedikuara.
- **Restaurimi dhe mirëmbajtja e të gjitha objekteve të kultit me vlerë**, si mënyrë për t'i bërë ato tërheqëse dhe funksionale për vizitorët.
- **Organizimi i itinerareve të posaçme** që lidhin objektet e kultit në një rrjet të strukturuar për vizitueshmëri më të lehtë.
- **Hapja e objekteve të kultit me status monument kulture** për publikun, duke siguruar orare të rregullta vizitash dhe udhërrëfyes informues.
- **Organizimi i festave dhe aktiviteteve fetare** në objektet e kultit në qark, duke ruajtur dhe promovuar ritualet dhe traditat lokale.
- **Rritja e rolit edukues** tek brezat e rinj për vlerën historike, kulturore dhe shpirtërore të trashëgimisë fetare.
- **Përfshirja e objekteve të kultit në guidat turistike**, si pjesë e ofertës së strukturuar për vizitorët vendas dhe të huaj.
- **Rritja e investimeve në infrastrukturën rrugore**, për të përmirësuar aksesin drejt objekteve të kultit që ndodhen në zona të brendshme dhe më të thella të qarkut.

Rezultatet e studimit tregojnë se banorët vendas janë të lidhur ngushtë me trashëgiminë fetare të zonës dhe e vlerësojnë atë si pjesë të rëndësishme të identitetit të tyre kulturor. Ata kanë perceptime të ndryshme lidhur me interesin që shfaqin vizitorët vendas dhe të huaj për objektet e kultit dhe për festimet fetare që organizohen në qark. Vënia në funksionim dhe hapja e objekteve të kultit për publikun ka ndikuar në rritjen e dukshme të vizitueshmërisë. Për komunitetin lokal, zhvillimi i turizmit fetar shihet si një mundësi reale për përfitime ekonomike dhe sociale.

Megjithatë, siç evidentohet edhe nga vetë banorët, shumë prej objekteve të kultit nuk arrijnë të ofrojnë më të mirën e tyre për vizitorët. Problemet e mirëmbajtjes, mungesa e menaxhimit profesional dhe infrastruktura e pamjaftueshme ndikojnë negativisht në përvojën e vizitorëve. Promovimi i këtyre monumenteve mbetet gjithashtu i kufizuar, duke bërë që një pjesë e mirë e tyre të mos jetë e njohur nga publiku i gjerë.

Situata vështirësohet edhe më tepër nga fakti se një numër i konsiderueshëm objektesh ndodhen në zona të brendshme dhe të vështira për t'u arritur, për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore të përshtatshme. Ndër sugjerimet kryesore të komunitetit për rritjen e vëmendjes së vizitorëve është përfshirja e objekteve të kultit në itinerare të strukturuar turistike, çka do të ndihmonte në promovimin dhe njohjen më të mirë të tyre.

2.2. Itineraret turistike

Ndërtimi dhe përmirësimi i rrjeteve kryesore të transportit, kanë favorizuar lidhjen e destinacionit të Korçës me zona të tjera brenda Shqipërisë si edhe me vendet ndërkufitare; Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut. Po kështu një rrjet komunikimi rrugësh dytësore, lidhin qytetet me zonat rurale dhe pranë tyre edhe qendrat e vizitueshme. Mbi bazën e këtyre rrjeteve të komunikacionit, për të vizituar atraksionet dhe objektet fetare të përmendura më sipër, mund të organizohen disa itinerare turistike-kulturore (figura 2). Këto mund të jenë në grupe apo individuale, me kohëzgjatje të kufizuar (ditore), një ditore por edhe më gjatë. Si të tillë do të përcaktonim:

Zona e Pogradecit: Manastiri dhe kisha e Shën Mërisë Trebinjë-Kisha e Shën Mërisë në Niçë-Bazilika e Linit-Rrënojat e pranë stacionit të peshkimit Lin

Zona e Pustecit: Kisha e Shën Mërisë Gollomboc-Kisha e Shën Mërisë në Ujdhesën e Maligradit- Shpella e Shën Mërisë Maligrad-Kisha e Shën Mitrit, Bezmisht- Shpella e Shën Mërisë Bezmisht

Voskopoja: Kisha e Shën Kollit- Kisha e Shën Mërisë- Kisha e Shën Thanasit- Kisha e Shën Mëhillit- Rrënojat e Kishës së Shën Pjetrit-Kisha e Shën Dëlliut (Shën Ilias)-Manastiri i Shën Prodhomit -Kisha e Shën Gjergjit Shpellskë- Kisha e Shën Triadhës Lavdar.

Vithkuq: Manastiri Shën Pjetrit dhe Pavlit- Kisha e Shën Gjergjit,- Kisha e Shën Mërisë- Kisha e Shën Mëhillit-Kisha e Manastirit të Shën Mërisë Lubonjë.

Itineraret e objekteve të kultit në qarkun e Korçës



Harta 2. Itineraret e vizitës së objekteve të kultit sipas vendodhjes së tyre në qarkun e Korçës

Boboshticë-Dardhë-Mborje: Kisha e Shën Jovanit- Kisha e Shën Mitrit- Kisha e Shën Mërisë (e re)- Kisha e Shën Gjergjit (Dardhë)- Kisha e Ristožit (Mborje).

Zona e Kolonjës: Kisha e Shën Kollit Kamenicë- Kisha e Shën Kollit në fshatin Vodicë- Kisha e Shën Kollit në fshatin Rehovë-Kisha e Shën Mërisë në Cerskë-Kisha Shën Kollit në Cerskë- Kisha e Shën Mërisë në fshatin Shalës- Kisha e Shwn Mërisë në Lashovë- Teqeja e Qesarakës- Tyrbja në Varrin e Hasan Zylo Kamberit (Starje)

Zona e Devollit: Kisha e Shën Kollit Hoçisht- Kisha e tre anargjendëve Kozma dhe Damian-Kisha e Sinicës

Qyteti i Korçës: Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit-Katedralja Ringjallja e Krishtit-kisha të tjera në qytet (jo monument kulture).

Nisur nga fakti që turistët e huaj që vizitojnë destinacionin janë pjesë e turistëve që vizitojnë Shqipërinë, agjensitë turistike duhet të përfshijnë si atraksione kulturore të vizitueshme edhe objektet e kultit në qarkun e Korçës.

3. Përfundime dhe sugjerime

Trashëgimia fetare përbën një pjesë thelbësore të trashëgimisë kulturore të qarkut Korçë dhe të trashëgimisë kombëtare në tërësi. Objektet e kultit, besimet, ritualet, praktikat dhe festat fetare janë tashmë atraksione që po tërheqin gjithnjë e më shumë interesin e vizitorëve vendas dhe të huaj.

Shumica e banorëve të qarkut janë të njohur me një pjesë të mirë të objekteve të kultit, janë të vetëdijshtë se ato janë pjesë e trashëgimisë kulturore dhe i frekuentojnë sidomos gjatë ditëve të shënuara dhe ritualeve fetare. Në perceptimin e tyre, banorët janë përgjithësisht të hapur dhe mikpritës ndaj vizitorëve të interesuar për objektet e kultit. Sipas mendimit të tyre, turistët shfaqin më tepër interes për historinë dhe besimet fetare të zonës, ndërsa më pak për festimet dhe ritualet fetare tradicionale.

Në vlerësimin e banorëve, trashëgimia fetare është një aset i rëndësishëm për komunitetin lokal. Megjithatë, rritja e vëmendjes së vizitorëve vendas dhe të huaj kërkon disa ndërhyrje të domosdoshme, si:

- Promovimi më i plotë dhe më efektiv i objekteve të kultit;
- Rritja e investimeve për mirëmbajtjen dhe restaurimin e monumenteve;

- Përfshirja e këtyre objekteve në itineraret turistike të strukturuar;
- Vendosja e guidave dhe informacionit interpretues në objektet me interes të lartë kulturor.

Evidentimi i qartë i trashëgimisë fetare do të ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt promovimit të kësaj pasurie. Përfshirja e saj në politikat dhe strategjitë e zhvillimit të qarkut, si edhe në planet e veprimit të bashkive, do të nxitnin jo vetëm mirëmbajtjen, por edhe përdorimin aktiv të saj. Nëse këto monumente menaxhohen mirë dhe vihen në funksion të zhvillimit të turizmit, ato mund të kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve lokale të qarkut.

Referenca

- Adhami, S. (2008). *Voskopoja e Ilustruar*. Tiranë: Mirgeer Alb.
- Alvarez, O., Gonzalez, M., & Fernandez, S. (2022). Religious Heritage: Reconciliation between Spirituality and Cultural Concerns. *Rupkatha Journal on Interdisciplinary Studies in Humanities, Vol.4, No.4,*, 1-13.
- Basha, B., & Zagdic, Z. (2025). Observation on Ottoman Religious Heritage Legacy in Elbasan City, Then and Now. *1st Balkan Studies Congress Proceedings 02* (pp. 171-190). Idefe Publication.
- Choe, J. (2024). Religious tourism. *Tourism Geographies, 27 (3-4)*, 830-839.
- Franceschini, C. (2024). A Concise Introduction to the World of Religious Heritage. In UNESCO, *Religious Cultural Heritage and Political Contestation. Culture and Religion in International Relations*. Palgrave Macmillan.
- Frashëri, G., & Dashi, S. (1978). Karakteristikat arkitekturore të disa xhamive të vendit tonë, Monumente historike në vendin tonë. *"Mihal Duri"*, 42.
- ICOMOS. (2005). *The World Heritage List, Filling the Gaps: An Action Plan for Future*. ICOMOS.
- Iliev, D. (2020). The evolution of religious tourism: Concept, segmentation and development of new identities. *Journal of Hospitality and Tourism Management 45*, 131-140.
- Kallamata, K. (n.d.). Kisha e Shen Gjergjit Shipske. *Guide*.
- Kandil, E. (2024). Interpretation at Religious Heritage Sites. *International Journal of Multidisciplinary Studies in Architecture and Cultural Heritage, Volume 7, Issue 1,* 1-11.

- Kombieni, H. A. (2025). Cultural and Religious Heritage in the Commune of Cove (Benin): Current Situation and Social-Economic Implications. *Journal of Social Sciences*, Vol. 13.No.4, 1-25 DOI: 10.4236/jss.2025.134001.
- Llukani, A. (2019). *Ndihmesa e Theofan Popes per shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare.*
- Llukani, A. (2019). *Ndihmesa e Theofan Popës për shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike.*
- Ma, J. (2023). Religious Heritage Conservation and Community Engagement under the Threshold of Heritage Revitalization in Ningxia. *Frontiers in Humanities and Social Sciences*, Volume 3, Issue 8, , 1-6.
- Meksi, A. (2007). *Arkitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV-XIX)*. Tiranë: UEGEN.
- Menkshi, E. (2020). *Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e Qarkut Korçë (vlerat dhe përdorimi turistik)*. Korçë: Promo Print.
- Pepo, P. (1981). *Kodiku i Korçes dhe Salasforit*.
- Rinschede, G. (1992). *Forms of Religious tourism. Annals of Tourism Research*, 19 (1).
- Ron , A. S. (2009). Towards a Typological Model of Contemporary Christian Travel. *Journal of Heritage Tourism* 4 (4), 287-297.
- Sanchez, D. A., Garcia, J. A., Rama, D. R., & Oliveira, C. (2018). Religious Tourism and Pilgrimage: Bibliometric Overview. *Religions* 9, 249.
- Santiago, J. (2023). The Impact of Religious Rituals on Cultural Identity: Review of the Relationship between Religious Practices and Cultural Belonging. *International Journal Of Culture and Religious Studies*, Vol. 4, Issue Nr.2, 13-22.
- Shehu, B., & Zaloshnja, E. (2024). *Statistical Study on Religious Belief in Albania*. Tirana: Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS).
- Tamma, M., & Sartori, R. (2017). Religious Heritage: Sharing and Integrating Values, Fruition, Resources. *Cultural Heritage, Scenarios 2015-2017*, 557-572.